

OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT
DEPARTAMENTI I FINANCËS
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 901/prot.
3

Tiranë, më 23.12.2021

Lënda: Përgjigje shkresës Nr.914/7, datë 16.12.2021 “Kërkesë për informacion”.

ENTIT RREGULLATOR TË ENERGISË
Blvd. “Bajram Curri”, Rr. Viktor Eftimiu 1023, Tiranë

I nderuar Z. Ahmeti,

Në përgjigje të shkresës suaj Nr.914/7, datë 16.12.2021, “Kërkesë për informacion”, lutem gjeni informacionin e kërkuar si mëposhtë vijon:

- Duhet të dërgohen Tabelat e shpenzimeve dhe të ardhurave të realizuara për vitin 2020 krahas 11-mujorin 2021 dhe parashikimit për muajin dhjetor 2021, si dhe periudhën 2022-2024. Të dhënat duhet të paraqiten në formë analitike për secilën kategori dhe nënkategori, të shoqëruara me arsyetimet përkatëse si dhe dokumentacion justifikues.*

Nisur nga proceset e mëparshme, OST ka krijuar eksperiencën e nevojshme mbi përcaktimin e tarifave të transmetimit, ku çdo e dhënë e kërkuar nga ERE me anë të korrespondencave respektive, është përcjellë prej saj dhe është argumentuar nga pikepamja rregullatore. Të dhënat e pasqyrave financiare paraqesin aktivitetin e shoqërisë në tërësi dhe jo sipas parimeve dhe kërkesave rregullatore në mbështetje të metodologjisë, ku kërkesat e kësaj të fundit përcaktojnë të dhënat e domosdoshme që shërbejnë për llogaritjen e një tarife të drejtë..

Në lidhje me këtë çështje, realizimin e të ardhurave dhe shpenzimeve në formë analitike për vitet 2019, 2020 dhe 11 mujorin 2021, pasqyrohet në tabelat e mëposhtme.

20 Te ardhurat nga shërbimi I transmetimit dhe te ardhurat e tjera

	<u>30 Nentor 2021</u>	<u>31 Dhjetor 2020</u>	<u>31 Dhjetor 2019</u>
Te ardhura nga shërbimet e transmetimit	5,180,094,523.52	5,251,398,208	5,258,467,977
Te ardhura nga alokimet e kapaciteteve	1,080,116,231.56	1,381,209,449	1,737,622,845
Te ardhura nga disbalancat e energjise	961,149,096.62	220,218,773	
Te ardhura nga transmetimi nderkufitar	13,302,286.75	18,592,561	3,014,858
	7,234,662,138	6,871,418,990	6,999,105,680

21 Shpenzime për materiale

	30 Nentor 2021	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Materiale konsumi	36,815,277.13	40,352,094	66,496,056
Lende djegese	34,939,228.97	37,332,387	44,730,987
Te tjera	1,602,258.60	1,521,159	1,907,903
	73,356,765	79,205,640	113,134,946

22 Kosto transmetimi

	30 Nentor 2021	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Shpenzime te transmetimit nderkufitar	244,779,383	179,482,666	173,340,909
Humbjet teknike gjate transmetimit	1,585,303,845	842,283,131	990,521,557
Sherbimet ndihmese	367,912,843	151,893,140	148,001,850
Humbje nga disbalancat e energjise			56,160,185
	2,197,996,071	1,173,658,937	1,368,024,501

23 Shpenzime te tjera nga veprimtarite e shfrytezimit

	30 Nentor 2021	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Qira	1,504,324	847,094	509,370
Mirëmbajtje dhe riparime	111,136,389	129,324,370	195,314,104
Sigurime	12,520,877	2,063,571	2,141,203
Kërkime, trajnime dhe studime	117,944,731	73,860,792	55,736,184
Personel jashtë njesisë	103,993,747	107,674,848	164,195,294
Shpenzime për patenta, licensa dhe të ngjashme	26,289,689	16,219,456	18,110,500
Publicitet, reklama	181,808	10,998,162	1,371,119
Transferime, udhëtime, dieta	27,908,111	14,705,939	33,939,133
Shpenzime postare dhe telekomunikimi	10,987,325	14,825,578	15,842,632
Shpenzime për shërbimet bankare	1,607,866	1,637,822	2,330,480
Taksa dhe tarifa vendore	1,190,225	664,405	449,641
Taksa e regjistrimit	2,061,778	2,465,498	2,528,955
Tatime të tjera	65,983	43,550	46,950
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	538,613	277,444	1,265,257
Gjoha dhe dëmtshpërblime	7,160,372	153,164,731	234,491,828
Shpenzime per jashte perdorimit	657,000	-	321,101
Tarifa antaresimi dhe te tjera	99,101,902	129,493,244	97,694,060
	524,850,742	658,266,505	826,287,811

Shpenzimet per personel jashte njesise detajohen si me poshte:

	30 Nentor 2021	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
Vleresim I aktiveve afatgjata materiale		405,000	55,956,000
Vleresim I huave afatgjata me vleren e drejte	1,950,000	1,100,000	1,260,000
Auditim I pasqyrave financiare nga auditues ligjore caktuar nga MFE	4,950,000	4,968,000	4,968,000
Auditim I pasqyrave financiare nga shoqeri e pavaruar audituese	1,250,000	1,250,000	1,250,000
Rritje kapitali e shoqerise	1,605,000		2,397,000
Keshilli M bikqyres	1,759,909	1,788,700	2,380,140
Te tjera	744,800	85,000	
Roje private	91,734,038	98,078,148	95,984,154
	103,993,747	107,674,848	164,195,294

Duke u nisur nga të dhënat e përditësuara, rezultati i pritshëm për vitin 2021 paraqitet sipas tabelës së mëposhtme.

Pasqyra e te ardhurave dhe shpenzimeve	Njesia Matëse	2021
Te Ardhurat Operative		
Transmetimi i energjise	Mln lekë	5,730
Alokimi i kapaciteteve	“”	1,210
Të ardhura nga telekomunikacioni	“”	15
Të ardhura nga tregu i balancimit	“”	961
Te ardhura nga Grantet	“”	67
Te Ardhura te Tjera	“”	29
Totali i te Ardhurave Operative	Mln lekë	8,012
Shpenzimet Operative		
Blerja e humbjeve		-2,086
Blerja e sherbimeve ndihmese	“”	-498
Pagesë ITC	“”	-261
Materiale të para	“”	-103
Personeli	“”	-1,263
Amortizimi	“”	-2,405
Furnitoret dhe Sherbimet (Te tjere)	“”	-546
Totali i Shpenzimeve Operative	Mln lekë	-7,162
Rezultati Operativ	“”	849
Totali i te Ardhurave Financiare	Mln lekë	0
Totali i Shpenzimeve Financiare	Mln lekë	-560
Rezultati Financiar	Mln lekë	-560
Fitimi para taksave	Mln lekë	290
Tatim Fitimi	Mln lekë	-43
Fitimi i Vitit	Mln lekë	246

Duke u nisur nga realizimi i pritshem per vitin 2021, është bërë përditësimi i kostove të parashikuara për personelin. Vlerësimet për kostot operative për periudhën 2022-2024, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

C operuese	Milionë lekë	2022	2023	2024
		8,458	7,681	7,428
Personeli	“”	1,373	1,399	1,425
Sherbime administrative e te tjera	“”	733	711	715
Menaxhimi i kongjestionit me ridispecim	“”	521	558	595
Materiale të para	“”	132	134	136
Blerja e sherbimeve ndihmese	“”	1,708	1,924	2,050
Blerja e humbjeve	“”	3,741	2,705	2,257
Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	“”	250	250	250

2. Për qëllime të analizës së parashikimeve për vitin 2022, paraqisni informacion analitik në lidhje me:

-lëvizjen e numrit të punonjësve 2019-2021

-realizimin e shpenzimeve të personelit për periudhën 2019-2021 duke argumentuar rritjen e propozuar të këtij shpenzimi për periudhën 2022-2024

- organigramën e plotë të shoqërisë së bashku me borderonë e pagave të muajit Tetor 2021 ku duhet të evidentohen niveli i pagave, trajtimeve financiare dhe çdo zë tjetër përbërës të

shpenzimeve të personelit të ndarë për secilën nga kategoritë e punonjësve për aktivitetin e transmetimit dhe aktiviteteteve të tjera të shoqërisë dhe jo vetëm sipas njësisë.

Vërejmë se, në shkresën sipërcituar, keni përcjellë vetëm shpjegime narrative të parashikimeve tuaja për realizimin e këtij shpenzimi për Vitin 2021.

Sa më sipër, ashtu si dhe diskutuar në seancën dëgjimore të datës 03.12.2021, duhet të përcillni në ERE analizen tuaj lidhur me parashikimin në rritje të këtij shpenzimi për Vitin 2021, e më tej për periudhën rregullatore 2022-2024, kundrejt realizimit të tij për vitet 2019- 2020, në kohën kur zërat e ndryshëm të kostove që ju i referoheni si “shtesa turnesh dhe orë jashtë orarit”, “udhëtime dhe dieta”, “shpenzime të tjera personeli” janë shpenzime të cilat i keni realizuar dhe në vitin 2020. Argumentoni cilët faktorë priten të ndikojnë në parashikimin tuaj në rritje të shpenzimeve të personelit.

Sqarojmë se organigrama e OST e përcjellë prej jush është lehtësisht e aksesueshme në faqen tuaj të internetit, por nuk i përgjigjet kërkesës së ERE, derguar me shkresë nr. 914/4 Prot, datë 26.11.2021.

Në lidhje me këtë çështje, realizimi dhe parashikimet për kostot e personelit, në mënyrë analitike, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Shpenzimet e Personelit	Njesia	2019	2020	2021	2022	2023	2024
Fondi i pagave	Leke	741,158,888	736,854,112	766,856,015	797,530,255	813,480,860	829,750,478
Pagesa për turne dhe orë jashtë orarit	"	41,341,141	38,232,017	45,036,590	45,937,322	46,856,069	47,793,190
Shpenzime ushqimi për punonjësit	"	87,401,445	82,125,000	85,521,000	93,093,000	94,954,860	96,853,957
Shpenzime për udhëtime dhe dieta	"	33,939,133	14,705,939	30,665,316	31,278,623	31,904,195	32,542,279
Sigurimet shoqërore dhe shëndetsore	"	147,046,243	145,966,953	155,149,931	158,252,929	161,417,988	164,646,348
Shpenzime page për vjetërsi në punë	"	84,571,648	87,741,192	87,118,190	88,860,554	90,637,765	92,450,521
Fondi suplementar i pensionit	"	32,224,480	32,974,261	37,813,139	38,569,402	39,340,790	40,127,605
Shpenzime të tjera Personeli	"	35,910,728	25,973,785	43,214,551	44,078,842	44,960,419	45,859,627
Shperblime	"		3,505,140	11,220,000	75,000,000	75,000,000	75,000,000
Totali Shpenzime Personeli	Leke	1,203,593,706	1,168,078,399	1,262,594,733	1,372,600,928	1,398,552,946	1,425,024,005
Nr. mesatar i punonjësve	Nr	761	760	782	806	806	806
Paga mesatare	Leke/Muaj	81,161	80,795	81,720	82,458	84,107	85,789

Gjithashtu, bashkelidhur këtij material do të gjeni dhe borderotë e detajuara për muajin tetor 2021.

- Në lidhje me parashikimin tuaj për zërin “materiale të para” vërejmë se keni përcjellë vetëm deklarime narrative, ku parashikimet tuaja janë kryer duke marrë në konsideratë ecurinë historike të tyre si dhe rritjen e çmimeve të lëndës djegëse. Sa më sipër, përcillni në ERE analizat krahasuese mbi koston historike të realizimit të këtij shpenzimi për periudhën 2019-2020 si dhe efektin e pritshëm në rritje të secilit faktor, i cili ndikon në shpenzimet e parashikuara për Vitin 2021 dhe periudhën 2022-2024.

Në lidhje me këtë çështje, sqarimi është dhënë në pikën 1.

- Për zërin “shërbime administrative të tjera” në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare për Vitin 2020, konstatohet se vlera e realizuar në total e këtij shpenzimi (pa përfshirë gjoba dhe dëmshpërblime) është rreth 505 milion lekë, ndërkohë që në aplikimin e paraqitur në ERE rezulton në vlerën 642 milion lekë. Ndërkohë për Vitin 2021 kjo vlerë është parashikuar 606 milion lekë dhe Vitin 2022 në vlerën 732 milion lekë. Sa më sipër, lutem rishikoni të dhënat e depozituara në ERE, duke i paraqitur në formë analitike vlerat e secilit zë dhe nën zë përbërës të këtij grup shpenzimi.

Në këtë zë të shpenzimeve, pasqyrohen kryesisht kosto periodike për shërbimet vjetore të kompanisë si ruajtja e objekteve; tarifat e angazhimit në organizmat rajonalë; mirëmbajtja e

platformave të software; mirembajtja e automjeteve; mirëmbajtja e godinave dhe ambjenteve të OST sh.a.; shërbimet e auditimit; cyber-security, tarifa e ERE etj. Ecuria dhe parashikimet janë pasqyruar në pikën 1 si dhe në korrespondencat e mëparshme.

Në lidhje me “Automjetet me qera operationale”, bashkelidhur po ju dërgojmë kontraten e kërkuar.

Në lidhje me “kompensimin e disbalancave në rast avarie”, ju sqarojmë se:

Vendimi Nr 106 /2020 ERE “Mbi Miratimin e Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” parashikon se kompensimi i disbalancave të cilat shkaktohen nga shkeputja e përdoruesve të lidhur në Rrjetin e Transmetimit, në raste të avarie në rrjet, duhet të mbulohej nga OST. Nga eksperiencia e deritanishme rezultoi se sasia e energjisë së ‘munguar’ që duhet të kompensohet është e rendit 850 MWh në vit.

Përdoruesi gjenerues nuk penalizohet me disbalance negative. Disbalanca e krijuar mbulohej nga OST. Përdoruesi konsumator nuk penalizohet me disbalance pozitive, por kompensohet nga OST me cmimin e blerjes së energjisë nga furnizuesi perkates.

Viti	Sasia e energjisë që duhet të kompensohet nga OST [MWh]	Cmimi mesatar [€/MWh]	Fondi [€]
2022	850	80	68,000
2023	850	85	72,250
2024	850	90	76,500

5. Nga analiza e dokumentacionit të përcjellë, raporteve të publikuara lidhur me blerjet e humbjeve në tregun e lirë dhe deklaratimet e përfaqësuesve tuaj në seancën dëgjimore teknike, paraqisni në ERE realizimin faktik të këtij shpenzimi në vlerë dhe sasi, mbështetur në procedurat e blerjes së humbjeve në tregun e lirë (energji të prokuruar në profilet bazë dhe në pik). Duke u mbështetur në realizimin faktik, lutemi të rishikoni parashikimet tuaja lidhur me koston e blerjes së humbjeve për vitin 2021 dhe periudhën 2022-2024. Mbështetur në metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike dhe Rregullat e tregut të balancimit në fuqi, për efekt të përllogaritjes së tarifës së transmetimit, do të konsiderohen vetëm kostot për sasi të energjisë elektrike lidhur me humbjet në transmetim dhe jo kostot e disbalancave për këtë shërbim

Përsa i përket zërit të prokurimit të energjisë elektrike për mbulimin e Humbjeve në rrjetin e transmetimit, në tabelën e mëposhtme pasqyrohet prokurimi i humbjeve në sasi dhe në vlerë deri me datë 23.12.2021.

Muaji	Fakti 2021		
	Sasia [MWh]	Vlera [Euro]	Cmimi [€/MWh]
Janar	19,823	1,341,674.54	67.68
Shkurt	20,440	881,882.40	43.14
Mars	23,080	1,173,925.75	50.86
Prill	12,750	606,162.30	47.54
Maj	15,965	800,741.78	50.16
Qershor	18,395	973,242.40	52.91
Korrik	14,485	945,076.17	65.25
Gusht	15,190	1,237,148.16	81.44
Shtator	12,718	1,068,518.16	84.02
Tetor	10,322	1,702,413.35	164.93
Nentor	10,829	2,214,052.64	204.46
Dhjetor	16,507	4,167,327.42	252.46
TOTAL	190,504	17,112,165	89.83

Gjithashtu, sqarojmë se në aplikimin për tarifë, OST sh.a. ka paraqitur vetëm kostot e parashikuara për sasinë e energjisë për mbulimin e Humbjeve në rrjetin e transmetimit dhe në asnjë moment nuk janë përfshirë kostot e disbalancave të shkaktuara nga parashikimi për blerjen e energjisë për mbulimin e Humbjeve, për të cilat OST është palë përgjegjëse balancuese.

6. Lidhur me "Menaxhimin e kongestionit me ridispecerim", në shkresën nr. 6954 Prot, datë 02.12.2021, bëni me dije se: "Analiza për parashikimin e këtij shpenzimi është realizuar bazuar në të dhëna teknike dhe eksperiencën shumë vjeçare të operimit të sistemit.

Në seancën dëgjimore, përfaqësuesit tuaj janë shprehur se për parashikimin e këtij shpenzimi janë mbështetur dhe në praktikën e ngjashme të aplikuar në vendet e rajonit.

Sa më sipër, paraqisni modelet e marra në konsideratë sa i takon praktikave të ngjashme nga vendet e rajonit sikurse deklaruar, si dhe një raport mbi analizen e kryer prej jush në parashikimin e kapacitetit prej 100 MW, numrin e ditëve potencialisht të mundshme për aplikimin e ridispecerimit prej 100 ditë, numrin e orëve potencialisht të mundshme prej 6 ore/ditë si dhe referencat e përdorura mbi çmimet e parashikuara për realizimin e tij në periudhën e ardhshme rregullatore 2022 - 2024..

Në vijim të sqarimeve të kërkuara nga ERE, përsa i përket vleresimit të kostove për këtë zë, duke qenë se OST ska pasur praktika të meparshme atëhere janë marrë në konsideratë praktika të vendeve në rajon dhe me gjere sipas publikimeve në platformen e transparencës së këtyre kostove, lutem linku si me poshte:

<https://transparency.entsoe.eu/congestion-management/r2/costs/show>

Në vijim, gjeni të përmbledhur rezultatin e analizes se realizuar nga OST për zonën e saj të kontrollit mbi sasinë e nevojshme të kapacitetit për menaxhimin e kongestionit me ridispecerim.

Ridispecimi si mekanizem, kuptohet si ndryshimi i pikes punes ne njesite gjeneruese, si mase parandaluese per te mos cenuar sigurine e sistemit te transmetimit, dhe konkretisht per te menjanuar mbingarkimin ne linjat 110kV. Ne rrjetin e OST sh.a. jane identifikuar 2 zona te mundshme, ku nisur dhe nga eksperienca e vitetve te kaluar, eshte e domosdoshme te aplikohet ridispecim. Ne zonen verilindore per shkak te topologjise se rrjetit dhe burimeve te reja hidro, jane indetifikuar keto linja:

Linjat 110kV Burrel- Suc- Darsi-Cerruje-Bulqize-Ternove-Gjorice-Shupenze-Vojnik-Peshkopi-Seta-Lashkiza (Linja 1).

Linjat 110kV Fierze-Arsti-F.Arrez-Dardhe-Lajthiza-Kalimash-Kukes-Bele-Lapaj-Veleshica (Linja 2).

Unaza verilindore ne periudhat me prodhim te larte te energjise elektrike nga HEC, operohet me skeme ne forme radiale per te arritur nje shperndarje te barabarte te flukseve te fuqise ne keto dy linja radiale. Aktualisht fuqite e instaluar te hidrocentraleve ne keto zone jane:

Linja Burrel		Linja Fierze	
Centrali	Fuqia Instaluar [MW]	Centrali	Fuqia Instaluar [MW]
Gjorice	32	Veleshica	20
Ternove	9	Lapaj	14
Cerrunje	13	Bele	31
Seta	15	Dardhe	9
Iashkiza	5	Arsti	4
Darsi	21	Injekttime	10
Injekttime	15	Totali	87
Total	109		

Nga fuqite e instaluara mund te vihet re se ne linjen 110kV qe del nga n/st Burrel fuqia e instaluar e HEC eshte ne vleren 109MW, nderkohe per nje operim normal, fuqia maksimale qe duhet te shihet ne kete linje ne n/st Burrel duhet te jete perafersisht ne vleren 65MW, qe do te thote se 44MW jane gjenerim te cilat duhen ridispecuar ne ulje. Nderkohe ne linjen qe del nga n/st Fierze gjenerimi total nga HEC eshte ne vleren 87MW, perseri duke aplikuar te njejtin kriter, eshte e nevojshme nje ulje afersisht 22MW. Ne total per zonen verilindore, kerkohet nje ulje gjenerimi 66MW.

Gjithashtu nje linje tjeter ku vihet re nevoja per ridispecim, eshte linja 220kV Fierze-Prizren, ku per shkak te gjenerimit te larte ne rastet me prurje te larta, bashkuar me injektimet ne Autotransformatorin, 220/110kV, 120MVA ne n/st Fierze, shkaktohet nje mbingarkim i linjes 220kV. Ne kete rast per te ulur ngarkimin e kesaj linje, si mase e mundshme eshte ridispecimi ne ulje ne centralin e Fierzes, ne masen 40MW.

Në mënyrë të përmbledhur, mund të themi se lind nevoja në total, për një ridispecim, në masen 100MW, për 6 ore/dite, për 100 dite, të cilat konsiderohen si dite me prurje të larta.

7. *Lidhur me shërbimet ndihmëse, keni deklaruar se:*

Kapaciteti i Rezervës së Mbajtjes së Frekuencës (FCR), njohur gjithashtu si rezervat e rregullimit primar, nuk llogaritet nga OST. Kjo rezerve përlllogaritet për sistemin tonë energjistik dhe të gjitha OST-të e zonës sinkrone europiane ku OST bën pjesë nga ENTSO-E, sipas një Modeli Probabilistik Simulimi i cili është në gjendje të llogarisë sasinë minimale të FCR-seë së nevojshme si kontribut i çdo OST-je, për të ruajtur frekuencën në gjendje të qëndrueshme brenda devijimit maksimal të frekuencës në gjendje të qëndrueshme për të gjithë zonën sinkrone.

Rritja e kapacitetit rezervë për aFRR, vjen si pasojë e detyrimit që ka OST për mbajtjen e balancës së SEE, me devijime minimale. Duke pasur në konsideratë, natyrën e devijimeve, ndikuar dhe nga zhvillimi burimeve të rinovueshme dhe integrimin e tyre në SEE, është e domosdoshme rritja e kapacitetit rezervë për përbalimin e devijimeve, të shkaktuara nga ndryshueshmëria e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e vogla hidro/solar që priten të lidhen në SEE.

Ideja kryesore është të dimensionohet FCR në mënyrë që zona sinkrone e ENTSO-E të jetë në gjendje të përballojë Incidentin e Referencës duke stabilizuar frekuencën e sistemit brenda devijimit maksimal të lejuar të frekuencës.

Studimi i faktorit të kontributit ka një rëndësi të vecantë pasi është i lidhur me karakteristikat e frekuencës së fuqisë së rrjetit të zonës sinkronie CE.

Ne fillim te cdo viti modelohet koficienti i kontributit, i cili përfaqëson kontributin e sistemit tone të transmetimit në stabilizimin e frekuencës për mbajtjen në balancë të zonës sinkrone. Frekuenca e rrjetit sinkron është treguesi i përbashkët për cilësinë e balancës të zonës sinkrone.

Metodologjia merr ne konsiderate sasite e gjenerimit dhe konsumit per perlllogaritjen e koeficientit.

Fuqia që duhet të injektohet si FCR per vitin 2022 është perlllogaritur si më poshtë:

$$P_{pi} = C_i * P_{pu}$$

$C_i = Pr_N / \Sigma Pr_N$ është koeficienti i kontributit për kontrollin FCR, Pr_N është gjenerimi total + konsumi në zonën e kontrollit dhe ΣPr_N është gjenerimi total + konsumi brenda zonës sinkrone të Evropës Kontinentale.

$$\Sigma C_i = 1.00$$

$\Sigma P_{pi} = P_{pu} = 3000$ MW Rezerva Primare e Kontrollit per Zonen Sinkrone UCTE

$$C_i = \frac{C_a}{C_{Sa}}$$
 është koeficienti kontributit për kontrollin FCR, C_{Sa} është gjenerimi total

brenda zones se kontrollit dhe C_a është gjenerim total brenda zonës sinkrone të Evropës Kontinentale.

Për sa më lart, duke qenë se metodologjia merr në konsiderate sasite e gjenerimit dhe konsumit per perlllogaritjen e koeficientit, edhe sasia e kapacitetit për cdo vit ndryshon ne varësi të sasisë së gjenerimit dhe konsumit në vendit.

Për vendin tonë, kjo sasi kapaciteti e perlllogaritur ka ndryshuar ne vite duke u luhatur nga vlera 6 MW deri ne ± 10 MW.

Persa i perket ndikimit te burimeve te rinovueshme qe priten te lidhen ne SE:

Gjatë dy viteve të fundit ka patur një numër të lartë ta aplikimeve për lidhje te centraleve fotovoltaike dhe eolike në rrjetin e transmetimit. Në aspektin gjeografik për vetë pozicionimin gjeografik të Shqipërisë, mundësitë për përhapjen e burimeve FV janë të shumta nga veriu deri në jug por zona me numrin më të madh të ditëve me diell mbetet ultesira perëndimore.

Në bazë të kërkesave të ardhura për lidhje me rrjetin e transmetimit dhe parashikimeve për lidhjen e tyre të mundshme me rrjetin e transmetimit pritet që kapacitetet e lidhjes së centraleve me erë dhe fotovoltaike në rrjetin e transmetimit të arrijnë:

- Deri në vitin 2023 pritet të ketë 220.4 MW
- 465.4 MW deri në 2028 dhe
- 915.4 MW deri në 2033.

Implementimi dhe futja ne operim e ketyre centraleve te burimeve te rinovueshme sjell nenoja shtese për FRR. Sepse, vete teknologjia e tyre sjell disa probleme:

- luhatjet e gjenerimit nga burimet e rinovueshme ndodhin në një hark kohor më të ngushte.
- nuk kane mundesi per te absorbuar fuqi reaktive (si rrjedhoje do perballemi me nivele te larta tensioni).
- gabimet e parashikimit afatshkurtër, deri ne.
- nderprerje te menjehershme te gjenerimit nga njesite e prodhimit, etj

Si rrjedhoje, per sa me siper, si edhe nga eksperienca te vendeve te ndryshme, zhvillimi burimeve te rinovueshme dhe integrimin e tyre në SEE, sjell domosdoshmerine e rritjes se kapacitetit rezervë per përbalimin e devijimeve.

8. Nga sa konstatohet prej PF të periudhave ushtrimore të kaluara shoqëria ka realizuar të ardhura të konsiderueshme nga alokimi i kapaciteteve. Argumentoni dhe shpjegoni se si janë përdorur këto fonde nga OST si dhe qëllimi i përdorimit të të ardhurave që shoqëria parashikon të realizojë në periudhën rregullatore të propozuar.

Ne lidhje me këtë çështje, ju sqarojmë që të ardhurat e siguruar nga alokimi i kapaciteteve, mbulojnë kostot e investimeve ne rrjetin e transmetimit.

9. Duhet të përcillen në ERE të dhënat të shoqëruara me argumenta dhe analizat përkatëse lidhur me përllogaritjen e komponentit të kthimit të kapitalit.

Duke ju referuar Metodologjisë së Llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike, për sa i përket komponentit AroE, në nenin 7, pika 4.4, thuhet se “Norma e lejueshme e kthimit mbi kapitalin duhet të vendoset nga rregullatori mbi bazën e nevojës së OST-së për të marrë fluksin e parave për shpenzime kapitale dhe shërbimin e borxhit afatgjatë duke gjykuar nga pasqyra e burimeve dhe përdorimit të fondeve në vitin bazë. Gjithë fitimet duhen përdorur për të mbështetur programin e shpenzimeve kapitale të OST-së dhe për të rritur vlerën e kontabilizuar të pjesës së kapitalit”. Duke mos patur një normë të tillë të vendosur nga rregullatori për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024, nga ana e OST sh.a., është vlerësuar një normë minimale për komponentin AroE i cili është marrë për bazë në aplikimin e OST sh.a. për tarifën e transmetimit.

10. Plotësoni sipas tabelës më poshtë të dhënat mbi huamarrjet për vitin 2021 si dhe huamarrjet që parashikoni të likujdoni për periudhën 2022-2024:

Ne lidhje me këtë çështje, në tabelën e mëposhtme do të gjeni informacionin e kërkuar.

Marre nga	Projekti	Monedha	Afati i kredise ne vite	Viti i fundit ku perfundon shlyerja e kredise	Gjendje e principallit te pasqyret te kredise afatgjate ne fillim te vitit baze 2021	Pagesat e interesit te borshit afatgjate gjate vitit baze 2022	Disbursime gjate vitit 2022	Pagesat e principallit te borshit afatgjate gjate vitit baze 2022	Gjendje e principallit te pasqyret te kredise afatgjate ne fillim te vitit te dyte (31.12.2022)	Pagesat e interesit te borshit afatgjate gjate vitit te 2-te (2023)	Disbursime gjate vitit 2023	Pagesat e principallit te borshit afatgjate gjate vitit baze 2023	Gjendje e principallit te pasqyret te kredise afatgjate ne fillim te vitit te treta (31.12.2023)	Pagesat e interesit te borshit afatgjate gjate vitit te 3-te (2024)	
KESH	IBIC Rehabilitimi i Hece-ve te kaskades se Drinit-Fierze & V.Dejes	YEN	16 vite	2025	471,531,834.92	5,795,280.69		52,454,432.64	419,057,392.28	5,795,280.69		52,454,432.64	366,602,959.64	5,795,280.69	
	World Bank (Nr. 36710 AIB) (Gov.AI)	USD	15 vite	2024	167,429,312.82	4,210,972.64		17,051,598.92	150,377,713.90	4,210,972.64		17,051,598.92	133,326,114.98	4,210,972.64	
	World Bank (Nr. 38720 AIB) (Gov.AI)	USD	17 vite	2026	52,789,745.72	1,246,014.28		3,614,490.63	48,668,255.10	1,246,014.28		3,614,490.63	45,053,764.47	1,246,014.28	
	E.B.R.D. (Nr. 23830)	EUR		2014	45,632.93	-		-	45,632.93	-		-	-	45,632.93	
	E.B.R.D. (Nr. 33833)	EUR		2019	29,392,684.81	-		-	29,392,684.81	-		-	29,392,684.81	-	
	E.B.R.D. (Nr. 36112)	EUR		2018	862,655,551.87	-		-	862,655,551.87	-		-	862,655,551.87	-	
	Swiss Grant (Gov.AI) SECO	CHF	15 vite	2024	963,038,577.10	-		102,487,400.00	860,551,177.10	-		-	758,037,777.10	-	
	European Investment Bank (Nr. 21264)	EUR		2021	774,247,818.72	-		-	774,247,818.72	-		-	774,247,818.72	-	
	EIB - Vllora Thermo Power Plant (Nr. 22706)	EUR		2021	30,545,052.98	-		-	30,545,052.98	-		-	30,545,052.98	-	
	J.B.I. C-Japan (ABA-P2)	YEN	17 vite	2026	21,765,582.31	501,216.61		1,668,079.31	20,097,503.00	501,216.61			1,668,079.31	501,216.61	
	Exp. Imp. Bank of Korea-No AIB-1(Gov.AI)	EUR	25 vite	2034	1,888,116,096.66	49,687,164.12		108,833,734.71	1,779,282,361.95	49,687,164.12			1,670,448,627.24	49,687,164.12	
	KW - BISABU Project (Gov.AI) - Tranche I & II	EUR	35 vite	2044	126,112,839.01	943,687.83		4,414,997.48	121,697,841.53	943,687.83			4,414,997.48	943,687.83	
	KW-Linja Tirane - Podgorice.	EUR	35 vite	2044	1,268,325,983.45	1,986,007.99		10,554,215.20	1,257,771,768.24	1,986,007.99			10,554,215.20	1,986,007.99	
	Comm.AID'98 (10 mid LIT)	EUR	19 vite	2028	129,660,984.25	1,293,676.10		10,349,401.71	119,311,582.54	1,293,676.10			10,349,401.71	1,293,676.10	
	Rishte teknik & menaxhues - KESH, ITC 5	EUR	31 vite	2040	1,216,535,074.42	6,890,507.97		1,226,535,074.42	6,890,507.97	95,701,499.54			1,630,833,574.87	6,890,507.97	
Rishte teknik & menaxhues - KESH, ITC 5	USD	21 vite	2032	2,021,498,479.00	21,587,114.45		160,105,456.65	1,861,392,972.35	21,587,114.45			1,701,387,815.74	21,587,114.45		
TOTALI				10,535,163,951.00	94,141,642.48		471,513,467.25	10,063,650,483.75	94,141,642.48			547,215,306.79	9,494,434,836.96	94,141,642.48	
Mof	Artigjanca	EUR	38 vite	2045	6,215,769,365.61	125,756,689.88		6,215,769,365.61	125,756,689.88			6,215,769,365.61	125,756,689.88		
	Linja 400 kV Tirane-Pishqine 42 mil	EUR	14 vite	2024	4,545,156,325.41	145,570,547.09	72,771,991.43	575,959,999.18	4,042,008,237.67	147,906,528.03		575,959,999.18	3,466,048,238.49	147,906,528.03	
	Linja 110 kV Shqiperi e Jugut 37.25 mil	EUR	14 vite	2024	3,562,853,648.93	128,836,630.35	146,281,358.12	548,129,941.92	3,064,051,065.13	133,567,342.32		548,129,941.92	3,012,884,876.37	133,567,342.32	
	Linja 110 kV Shqiperi e Jugut 05 mil	EUR	39 vite	2049	1,329,274,991.40	9,950,237.50		44,184,360.00	1,285,090,631.40	9,950,237.50		44,184,360.00	1,241,406,271.40	9,950,237.50	
	Linja 110 kV Shqiperi e Jugut 05 mil	EUR	29 vite	2039	2,212,693,009	44,745,000.00		2,962,000.00	1,921,013,009	44,745,000.00		2,962,000.00	1,624,533,009	44,745,000.00	
	Linja 400 kV Shqiperi - Makedoni 50 mil	EUR	12 vite	2028	29,821,203.08	1,831,390,396.56		1,831,390,396.56	54,369,261.93	3,068,602,382.36		336,599,999.10	4,563,392,779.82	3,068,602,382.36	
	eficienca energjike programi per sektorin e nergjise elektrike 40 mil	EUR	14 vite	2029	844,512,921.90	71,445,973.65	548,478,480.00	3,738,689,986.62	83,255,600.00	3,862,168,480.00		548,478,480.00	3,180,211,506.62	83,255,600.00	
	Projektet per rimekzblime e nergjise elektrike *	LEKE	21 vite	2036	1,045,613,395.00	9,925,528.22		84,320,761.40	961,292,833.60	9,925,528.22			84,320,761.40	876,972,072.20	9,925,528.22
	TOTALI				17,965,909,461.34	521,810,559.86	5,493,099,290.83	1,804,035,622.50	21,654,967,129.67	566,835,887.88	3,068,602,382.36	3,068,602,382.36	2,140,835,868.44	22,582,933,643.59	585,814,652.75
					28,499,067,412.33	615,957,202.53	5,493,099,290.83	2,275,549,429.75	31,716,617,273.42	660,777,530.55	3,068,602,382.36	3,068,602,382.36	2,707,851,175.23	32,077,368,480.55	679,956,295.42

11. Lidhur me planin e investimeve për periudhën rregullatore 2022-2024, sjellim në vëmendjen tuaj se neni 10, pika 6 e "Rregullores së Procedurave të Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve" nuk pengon OST sh.a. në përcjelljen e kërkesës formale për miratimin e planit të investimeve për periudhën rregullatore, pasi procedura e paraqitjes së planit të investimeve është e përcaktuar fillimisht në pikën 4 të nenit 10.

Në kuptim të sa më sipër, OST Duhet të dërgojë në ERE planin e investimeve për periudhën rregullatore 2022-2024 si një aplikim më vete në zbatim të përcaktuar të pikës 5, nenit 60, të ligjit nr. 43/2015 "Për sektorin e energjisë elektrike" i ndryshuar, dhe kërkesave të "Rregullores së Procedurave të Paraqitjes dhe Miratimit të Planit të Investimeve" e miratuar me vendimin nr. 135/2017 të Bordit të ERE-s. Çdo investim i parashikuar duhet të shoqërohet me relacione shpjeguese dhe studimet e fizibilitetit e më e rëndësishmja Analiza kosto përfitim,

në mënyrë që të evidentohet dhe analizohet përfitimi ekonomik, financiar dhe teknik që këto investime pritet të sjellin për OST sh.a. në periudhën pasardhëse rregullatore.

OST në respekt të detyrimeve ligjore, rregullores së përmendur nga ERE dhe procedurave të brendshme të kompanisë rithekson se paraqitja formale e kërkesës për miratimin e Planit të Investimeve për periudhën rregullatore 2022÷2024, do të bëhet menjëherë pasi të jetë miratuar Programi i Zhvillimit Ekonomik të OST sh.a. për vitin 2022 jo vetëm nga Këshilli Mbikqyrës i OST por dhe nga MIE, hartimi dhe miratimi i të cilit është i lidhur me ecurinë e procesit të miratimit të tarifës së transmetimit për vitin 2022.

Kjo për të evituar çdo ndryshim të mundshëm të zërave të investimeve duke patur parasysh dhe situatën pas marrjes së vendimit Nr.584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”.

Paraqisni argumenta dhe sqarime mbi zërin e investimeve Ndërtimi N/stacionit të ri 110/35/20kV Palasë dhe linjës 110kV. A është parashikuar të ndërtohet dhe operohet nga mbështetur në parimin “used and usfeul” dhe a është konsideruar si kosto kapitale e drejtë dhe për tu mbuluar nga përdoruesit e rrjetit të transmetimit.

Në lidhje me ndërtimin e Nëstacionit të Palasës dhe linjës 110kV aktualisht nuk ka ndonjë zhvillim të mëtejshëm referuar përgjigjes së fundit të paraqitur nga OST në shkresën me Nr.A4513/1Prot datë 08.09.2021 në përgjigje të shkresës së ERE me Nr.817/1 datë 12.07.2021 të kushtëzuar dhe prej vendimit Nr.584, datë 08.10.2021 “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”.

Për kujtesë ritheksojmë se OST është detyruar të veprojë pas kërkesës nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës të protokolluar në OST me nr.4552Prot, datë 23.07.2020 ku kërkohet marrja e masave paraprake nga OST për plotësimin e nevojave për furnizimin me energji elektrike të Tunelit të Llogarasë, për të vijuar më tej me cilësimin tjetër në shkresë ku thesohet se është në fazë tenderimi rishikimi i studimit të fizibilitetit dhe hartimi i projektit të detajuar inxhinierik.

Gjithashtu OSSH ka derguar një shkresë të protokolluar në OST me nr.4593Prot, datë 21.07.2020, në të cilën veç te tjerave kërkohet bashkëpunimi me OST për planifikimin e zhvillimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes për shkak të zhvillimit të resorteve turisitike në zonën e Palas-Dhërmi-Himarë.

Strukturat përgjegjëse të OST në përgjigje të kërkesave të ardhura dhe të dhëna të disponuara kanë vlerësuar situatën aktuale të infrastrukturës energjitike në zonën e Himarë-Palasës dhe mundësinë e zhvillimit të saj në përputhje me planet zhvillimore të ngarkesës të paraqitur nga OSHEE dhe të MIE.

Megjithatë për të konkretizuar dhe saktësuar më tej detajet teknike dhe ekonomike të projektit, si vendodhja e saktë e tunelit, pozicionimi i nënstacionit elektrik të ri i Palasës, fuqia e tij dhe të dhëna të tjera të domosdoshme, duhet që nga ana e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë të vihet në dispozicion koordinatat e sakta të “Tunelit të Llogarasë” dhe projektin përkates të tij konform procedurave standarte të Lidhjes të sanksionuara në Kodin e Transmetimit, si dhe një bashkëpunim i ngushtë me strukturat përgjegjëse të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për të dalë me një variant final të dakortësuar të zhvillimit të rrjetit të transmetimit dhe të shpërndarjes në zonën Himarë-Palasë.

Për ndërtimin e Nstacionit të Palasës do të vijohet sipas hapave të ndjekur me ndërtimin e N/stacioneve 110kV Himarë dhe Orikum ku paraprakisht do të nënshkruhet një marrëveshje tre palëshe OST, OSHEE MIE në të cilën do të sanksionohen me detaje përgjegjësitë dhe të drejtat e secilës palë si dhe procesin e transferimit të aseteve te operatori i shpërndarjes. Megjithatë në çdo rast është MIE si iniciatore që do të orientojë palët e përfshira për kryerjen e këtij investimi.

OST do të vejë në dijeni ERE për çdo zhvillim rreth këtij investimi në të ardhmen. Bashkëngjitur për lehtësi do të rigjeni dhe shkresat e referuar në përgjigje të kësaj pike.

Gjithashtu për qellime të analizave tona, dërgoni në ERE në formë tabelare:

- Listën dhe vlerat e investimeve të miratuara nga ERE
- Ecuria e realizimit të tyre për periudhën 2015-2021
- Listën e investimeve në proces të shoqëruar me vlerësimet mbi nivelin e realizimit të investimit duke evidentuar dhe periudhën përkatëse sipas planeve të investimeve të miratuara nga ERE si dhe kohën që parashikohet që këto investime të hyjnë në operim.

Ecuria e realizimit të investimeve gjëndet në materialet bashkelidhur kësaj shkrese.

Përsa i takon informacionit të kërkuar “nëse shoqëria ka patur asete të cilat nuk kanë qënë në operim (stranded aset)”, sqarojmë që nuk ka asete të tilla.

12. Paraqisni informacion mbi masat e ndërmarra për mbylljen e marëdhënieve të ndërsjellta me OSSH dhe KESH, si dhe marrëveshjet respektive lidhur me planin e shlyerjes së këtyre detyrimeve me secilën palë.

Ne lidhje me këtë çështje, bashkelidhur do të gjeni marrëveshjet e nënshkruara mes OST sh.a.- OSHEE sh.a. dhe OST sh.a.- KESH sh.a., për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura.

Në përfundim,

Duke u bazuar: në sqarimet dhe materialet e dërguara me parë për aplikim për tarifën e transmetimit si dhe në vijim të sqarimeve, përditësimeve përsa i përket RAB, kostove të personelit dhe dokumentacionit shoqërues dhe pjesë e këtij materiali, si dhe në mbështetje të metodologjisë aktuale të llogaritjes së tarifës së transmetimit, nga ana e OST sh.a., janë pasqyruar efektet në llogaritjen e tarifës së transmetimit.

Kështu përsa i takon vitit 2021, vlerësimet tregohen si më poshtë:

Përkthimi	Unit	2020		2021		Te ardhurat e munguara		Te ardhurat e munguara 2020-2021
		Tarifa Aktuale	Tarifa sipas Metodologjisë	Tarifa Aktuale	Tarifa sipas Metodologjisë	2020	2021	
$C = C_{\text{kapital}} + C_{\text{operuese}} - \text{Te ardhurat nga aktivitetet e tjera}$		5.270	5.339	5.730	6.463	69	733	801
$C_{\text{kapital}} = R + D$		3.954	4.023	3.254	3.987			
I. Kthimi mbi kapitalin ($R = B * wacc$)	Million ALL	1.558	1.627	849	1.582			
a. B (Baza e rregulluar e aseteve)	***	38.003	38.003	37.004	37.004			
b. $WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + [DS * CoD]$	%	4.10%	4.28%	2.30%	4.28%			
ES - Objektiv për raportin e kapitalit te vet ne RAB	***	61.26%	61.26%	63.44%	63.44%			
T - Norma e takses se korporates	***	15.00%	15.00%	15.00%	15.00%			
ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	***	3.75%	4.00%	1.35%	4.00%			
DS - Objektiv për raportin e borshit ne RAB	***	38.74%	38.74%	36.56%	36.56%			
CoD - Kosto e borshit	***	3.61%	3.61%	3.53%	3.53%			
2. Amortizimi i vitit (D)	Million ALL	2.396	2.396	2.405	2.405			
II. C o peruese	***	3.064	3.064	4.757	4.757			
1 Personeli	***	1.168	1.168	1.263	1.263			
2 Shërbime administrative e te tjera	***	642	642	546	546			
3 Materiale të para	***	79	79	103	103			
4 Blerja e shërbimeve ndihmese	***	152	152	498	498			
5 Blerja e humbjeve	***	843	843	2.086	2.086			
6 Pagesë IIC (inter ISO Compensation mechanism)	***	180	180	261	261			
III. Te ardhurat nga aktivitetet e tjera	***	(1.748)	(1.748)	(2.282)	(2.282)			
E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjere)	GWh	7.027	7.027	7.640	7.640	7.027	7.640	14.667
Tarifa mesatare e transmetimit	Lek/kWh	0.75	0.76	0.75	0.85	0.01	0.10	0.05

Nga përlllogaritjet e bëra, të ardhurat e munguara për vitet 2021-2022, janë në masën 801 milionë lekë ose 0.05 leke/kWh, e cila duhet të merret në konsideratë nga ERE për tu përfshirë në rishikimin e tarifave.

Përsa i takon viteve 2022 - 2024, vlerësimet e rishikuara tregohen si më poshtë:

Metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë		2022	2023	2024	
Përskrimi					
	Njesia				
C = C kapital + C operues - Te ardhurat nga aktivitetet tjera		11,360	10,824	10,737	
I.	C kapital = R+D	4,287	4,576	4,794	
1	Kthimi mbi kapitalin (R = B*wacc)	1,601	1,746	1,870	
a. B (Baza e rregulluar e asetëve)		36,937	41,276	43,867	
b. WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)		4.33%	4.23%	4.26%	
ES - Objektivi për raportin e kapitalit të vet në RAB		63.8%	61.0%	61.6%	
T - Norma e taksës së korporatës		15.00%	15.00%	15.00%	
ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas taksës		4.00%	4.00%	4.00%	
DS - Objektivi për raportin e borxhit në RAB		36.82%	38.91%	38.44%	
CoD - Kosotë borxhit		3.70%	3.48%	3.55%	
2	Amortizimi i vitit (D)	2,686	2,830	2,924	
II.	C operues	8,458	7,681	7,428	
1	Personeli	1,373	1,399	1,425	
2	Sherbime administrative të tjera	733	711	715.00	
3	Menaxhimi i korigjimit me ridspecim	521	558	595	
4	Materiale të para	132	134	136	
5	Blerja e shërbimeve ndihmëse	1,708	1,924	2,050	
6	Blerja e humbjeve	3,741	2,705	2,257	
7	Pagesë ITC (Inter TSO Compensation mechanism)	250	250	250	
III.	Te ardhurat nga aktivitetet tjera	(1,385)	(1,433)	(1,485)	
E - Energjia e transmetuar (OSHEE + te tjere)		GWh	7,720	7,795	7,870
Tarifa mesatare e transmetimit		Le/kWh	1.47	1.39	1.36

Tarifa mesatare 3 vjeçare e transmetimit për llogaritjet të jetë **1.41 leke/kWh**

Mbetemi në dispozicion për çdo sqarim të mëtejshëm

Duke ju Falenderuar,

Me respekt,


ADMINISTRATORI I OST sh.a.
Skerdi Drenova
 ADMINISTRATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT